



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council**

**MEKANIZMI I RAPORTIMIT**  
**TË KRYEPROKURORËVE TË PROKURORIVE THEMELORE**  
**NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS**

**I. PJESA E PËRGJITHSHME:**

Emri, mbiemri Kryeprokurorit		Prokuroria		Periudha raportimit		Nënshkrimi						
Numri i prokurorëve dhe stafit administrativ në prokurori:		Kryeprokurori:		1	Administratori:		1					
		Nr. i prokurorëve në DKR:		13	Bashkëpunëtorë profesional:		35					
		Nr. i prokurorëve në DM:		7	Zyrtar ligjor:		34					
		Nr. i prokurorëve në DP:		30	Stafi tjetër:		47					
		Totali:		51	Totali:		117					
A) Numri i kallëzimeve penale të pranuar:		B) Numri i kallëzimeve penale të proceduara (zgjidhura/kryera):		C) Përqindja e rasteve të proceduara (B%A)		D) Ngarkesa me lëndë						
3.523		2.524		71.64%		50.699						
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga prokurori:	Aktakuza të ngritura:	Hudhje të kallëzimit penal:	Pushim i hetimeve:	Mënyrë tjetër:								
	1.207	317	173	69								
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata:	Aktakuza të hudhura:	Aktakuza të refuzuara	Aktgjykime liruese	Aktgjykimi dënues								
	405 (parashkrim)	7	6	664								
Ankesa kundër aktgjykimit gjithsej 14				Ankesa kundër aktvendimit								
Të aprovuara		Të refuzuara		Të aprovuara		Të refuzuara						
5		4										
<b>Arritshmëria e normës orientuese të prokurorëve, për periudhën kohore të raportimit:</b>												
Departamenti për Krime të Rënda:				%	6 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,							
Departamenti për të Mitur:				%	10 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,							
Departamenti i Përgjithshëm:				%	23 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,							
Arritshmëria e normës në Prokurori:				%	Mesatarja (3/1) e përqindjet në prokurori							
<b>Performanca e prokurorisë në luftimin e Korrupsionit (Padi të Penale 'PP'). Shëno të dhënat në tabelë:</b>												
Raste të pranuar;		Raste të kryera:		Ngarkesa me raste:		Hudhje	Pushim	Janë ngritur Aktakuza	Aktakuza hudhura	Aktakuza të refuzuara	Aktgjyki me liruese	Aktgjykimi dënues
R <sup>1</sup>	P <sup>2</sup>	R	P	R	P	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona
35	77	31	56	87	215	10	7	18			2	4

<sup>1</sup> 'R'-nëkupton rastet (kallëzimet penale)

<sup>2</sup> 'P' - nëkupton personat në kallëzime penale

Performanca në sekustrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Shëno të dhënat në tabelë:				
Kërkesa të aprovuara për dhënin e urdhrin për sekuestrim të përkohshëm	Kërkesa të aprovuara për konfiskimin e pasurisë dhe mjeteve financiare	Kërkesa të aprovuara për dhënin e asetëve në shfrytëzim të qeverisë	Kërkesa të aprovuara për dhënin e asetëve në administrim të AAPSK	Kërkesa për kompenzimin e palës së dëmtuar nga mjetet e konfiskuara
7				

## II. POLITIKAT DHE PRIORITETET E SISTEMIT PROKURORIAL:

## III. POLITIKAT DHE PRIORITETET E SISTEMIT PROKURORIAL:

1	<p>Niveli i organizimit, menaxhimit, administrimit dhe funksionimit të prokurorisë? Komento:</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, prill- qershor të vitit 2022, organizimi, menaxhimi, administrimi dhe funksionimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka qenë në brenda parametrave të përcaktuara.</p> <p>Zyra e Kryeprokurorit të PTH në Prishtinë ka funksionuar çdo ditë me orar të plotë të punës. Kryeprokurori ka organizuar dhe mbajtur kolegji me rregullta (periodike) me prokurorët e departamenteve të ndryshme. Përveç kësaj, ai ka qenë i gatshëm gjithmonë që të presë në konsultime prokurorët dhe hetuesit dhe të bashkëpunojë me ta për raste më të ndërlikuara. Përveç kësaj, kujdestarët në të gjitha departamentet kanë funksionuar në nivel shumë të mirë dhe reagimi i prokurorëve kujdestarë, përgjithësisht ka qenë i shpejtë dhe efektiv në trajtimin e rasteve të paraqitura.</p> <p>Po ashtu referuar dispozitës të nenit 156 të KPPRK-së, Kryeprokurori, ka zbatuar këtë dispozitë ligjore duke trajtuar analizuar rastet për të cilat ka filluar hetimi penal.</p> <p>Nga prokurorët kujdestarë është kërkuar raport me shkrim lidhur me mbarëvajtjen e kujdestarisë në mënyrë që të vazhdohet kronologjia e rasteve me hetuesit kompetent të rasteve si dhe të mbajnë të informuar Udhëheqësin e Departamentit përkatës, si gjatë kujdestarisë edhe pas çdo përfundimit të kujdestarisë. Të njëjtëve vazhdimisht iu është ofruar mbështetje si nga kryeprokurori ashtu edhe nga udhëheqësit.</p>
2	<p>Çështjet e avancimit dhe transferimit të prokurorëve? Komento:</p> <p>Gjatë periudhës raportuese është pranuar një prokuror i ri dhe janë transferuar 7 prokuror në Departamentin e Përgjithshëm.</p>
3	<p>Çështjet e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve apo stafit mbështetës? Komento:</p> <p>Gjatë periudhës Korrik-Shtator të vitit 2022, kemi pranuar nga tre (6) raste</p> <p>Prej tyre dy (5) janë parashtruar nga palët dhe 1 është hapur sipas detyrës zyrtare.</p> <p>Ndërsa në periudhë Korrik-Shtator të vitit 2022, janë kryer këto raste AD.nr. 06/2022, rast i iniciuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa me dt.13.07.2022 është marrë Vendim për refuzim, të ankesës. AD.nr. 07/2022, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.13.07.2022 është marrë Vendim për refuzim të ankesës. AD.nr. 08/2022, rast i iniciuar nga pala,</p>

	<p>ndërsa me dt.02.08.2022 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 09/2022, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.12.08.2022 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 10/2022, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.02.08.2022 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 11/2022, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.02.08.2022 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>AD.nr. 12/2022, rast i iniciuar nga pala, ndërsa me dt.10.08.2022 është marrë Vendim për refuzim të ankesës.</p> <p>Ndërsa sa i përket stafit mbështetës</p> <p>Në periudhën raportuese, janë shqiptuar tre (3) masa disiplinore Vërejtje me shkrim, për staf administrativ.</p>
4	<p>Çështjet e vlerësimit të punës së prokurorëve përfshirë mospajtimet e prokurorëve? Nivelet e vlerësimit të prokurorëve si dhe tejkalimi kuotës 20% të dalluar? Komento:</p> <p>Shqetësim i përgjithshëm që ndërlidhet me të gjithë prokurorët e të cilëve u janë dhënë rekomandime janë: Përpilimi i Akteve Akuzuese, të analizohen dhe shtjellohen të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës.</p> <p>Që gjatë përpilimit të aktakuzave kujdes i veçantë të i kushtohet evitimit të gabimeve teknike , strukturës të aktit akuzues në mënyrë që e njëjta ti përmbaj elementet e përcaktuara konform Legjislacionit në fuqi</p> <p>Këshillohet që çdo muaj të bëhet plani i veprimit për lëndët që do të trajtohen me prioritet në muajin pasues. Kësisoj, do të ketë një pasqyrë më të saktë rreth statusit të lëndëve dhe domosdoshmërisë për të marrë veprime.</p> <p>Është kërkuar nga prokurorët e Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion që të punojnë më shumë drejt ngritjes së aktakuzave dhe kryerjes së lëndëve.</p>
5	<p>Çështjet e rasteve të ndërlikuara dhe vendimet nga Kryeprokurori për njohjen e këtyre rasteve ? Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudha raportuese nuk kemi pasur ndonjë rasti të referuar nga ana e prokuroreve që i nijeti sipas Udhëzimit Administrativ nr.01/2018, për caktimin e normës orientuese për prokurorët e shtetit, të përcaktohet si rast i ndërlikuar.</p>
6	<p>Ankesat ndaj shqiptimit të sanksionit penal të shqiptuar (Udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit) ? Komento:</p>

Sa i përket Udhëzimit të Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit, i njëjti është pranuar fizikisht nga prokurorët e PTH në Prishtinë gjatë muajit prill –qershor të vitit 2022. Prokurorët janë udhëzuar që ta lexojnë dhe analizojnë me kujdes përmbajtjen e këtij udhëzimi dhe ta zbatojnë përpikmërisht sa herë që paraqitet e nevojshme për të ushtruar ankesë ndaj sanksionit penal të shqiptuar.

Për të vënë në zbatueshmëri Udhëzimin e Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit, Kryeprokurori i PTH në Prishtinë është vazhdimisht vigjilent ndaj aktgjykimeve, veçanërisht të lëndëve që bien në domenin e Departamentit për Krime të Rënda. Kryeprokurori i ka udhëzuar prokurorët e rasteve/përfaqësues që të ushtrojnë ankesë, çdo herë që sanksionet penale të shqiptuara nuk janë adekuate apo të mjaftueshme. Në kolegjiunet e mbajtura me prokurorët e të gjitha departamenteve, Kryeprokurori ka qenë i zëshëm për të adresuar problematikën e politikës ndëshkimore të gjykatës, ashtu që, që në kolegjiunin e parë të mbajtur në muajin janar, moszbatimi i Udhëzuesit për politikë ndëshkimore i Gjykatës Supreme ka qenë pikë e rendit të ditës. Kryeprokurori i ka tërhequr vërejtjen të gjithë prokurorëve që të analizojnë aktgjykimet dhe dënimet me kujdes dhe të vlerësojnë mundësinë për të paraqitur ankesë.

7 Zbatimi i politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit? Cilat janë kriteret e përzgjes së prokurorëve mentorë për prokurorët fillestar?

Komente:

Në këtë periudhë raportuese prokurorët janë angazhuar në pjesëmarrje në trajnime dhe atë:

Më datë 07-09.10.2022 është mbajtur trajnimi me temë "Trajnim për rastet që përfshijnë abuzim dhe mashtrim në prokurimin publik" ku kanë marrë pjesë dy prokurorë nga Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion.

Më datë 13-14.10.2022 është mbajtur trajnimi me temë "Trajnim i avancuar dy ditor për hetimin e narkotikëve" ku ka marrë pjesë një prokuror nga DP.

Më datë 15-16.10.2022 është mbajtur trajnimi me temë "Trajnim i avancuar dy ditor për hetimin e narkotikëve" ku ka marrë pjesë një prokuror nga DP.

Më datë 26-27.10.2022 është mbajtur trajnimi me temë "Trajnim për Hetimin Financiar" ku ka marrë pjesë gjashtembëdhjet prokuror nga DP dhe DKR.

Më datë 22.10.2022 është mbajtur trajnimi me temë "Trajnim për qasje në drejtësi për grupet e cenushme", ku kanë marrë pjesë dy prokuror nga DP.

Më datë 22.10.2022 është mbajtur tryeza me temë "Java së Ndërmjetësimit, Akademia e Drejtësisë dhe Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit/ Shërbimi Amerikan i Ndërmjetësimit dhe Pajtimit", ku ka marrë pjesë udhëheqësja e DP si dhe dy prokuror nga DP.

Më datë 16-17.10.2022 është mbajtur trajnimi me temë "Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale" ku kanë marrë pjesë dhjetë prokuror nga Njësi për Krime ekonomike dhe Korrupsion, DKR, DM dhe DP.

Më datë 26.10.2022 është mbajtur tryeza me temë "Ndërmjetësimi" ku kanë marrë pjesë dy prokuror nga DP si dhe dy zyrtarë për ndërmjetësim.

8 Niveli i zbatimit të Kodit të Etikës profesionale për prokurorë dhe stafin administrativ?

	<p>Komento:</p> <p>Sa i përket moszbatimit të Kodit të Etikës në Prokurorinë Themelore në Prishtinë ekziston dosje individuale për secilin prokuror ku deponohen shënime rreth veprimeve të tyre, e të cilat mund të kenë rol në vlerësimin e performancës vjetore.</p> <p>Sa i përket stafit mbështetës gjatë periudhës raportuese, në përgjithësi niveli i zbatimit të Kodit të Etikës Profesionale ka qenë i kënaqshëm.</p> <p>Në Prokurorinë Themelore në Prishtinë prokurorët i respektojnë të gjitha standartet e sjelljes konform Kodit të Etikës, si brenda ashtu edhe jashtë zyrës dhe kjo reflektohet pozitivisht në veprimtarinë e tyre profesionale. Përfundimisht, për prokurorët të cilët ka pasur pretendime se nuk e kanë respektuar.</p>
9	<p>Niveli i pavarësisë së prokurorëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale?</p> <p>Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese, prokurorët e PTH në Prishtinë e kanë kryer funksionin e tyre në mënyrë të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, si dhe në zbatim të drejtë të ligjit, duke mos u ndikuar nga brenda dhe jashtë. Kryeprokurori vazhdimisht u ka tërhequr vëmendjen prokurorëve që të shmangin çdo përpjekje të parregullt dhe të paligjshme, e cila mund të ndikojë në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre.</p>
10	<p>Zbatimi i politikave të KPK dhe ZKPSFL në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional ?</p> <p>Komento:</p> <p>Përgjatë periudhës së raportimit, një theks i veçantë i është dhënë ndjekjes penale të veprave karakteristike. Në kolegjiunet e mbajtura, shpeshherë këto vepra penale kanë qenë temë diskutimi dhe prokurorët janë udhëzuar që t'i trajtojnë me prioritet këto kategori të lëndëve.</p> <p>Sa i përket regjistrimit të lëndëve me kryerës të njohur PP, në PTH në Prishtinë, janë të dhënat si në vijim:</p> <p><u>Armët</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 13 raste të pazgjidhura. Për këtë kategori të veprave penale, rëndësi i është dhënë caktimit të kompetencës së rasteve ndërmjet Departamentit të Përgjithshëm dhe Departamentit për Krime të Rënda.</p> <p><u>Drogat</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 738 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 92 lëndë. Për herë të parë, për këtë kategori të veprave penale, një (1) prokuror është caktuar koordinator. Koordinatori përcjellë çështjet penale lidhur me narkotikët, mban evidencë për numrin e rasteve, mbështet prokurorët tjerë më këshilla sipas nevojës, njofton sipas kërkesës Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit lidhur më këto raste, si dhe merr pjesë në takime, seminare apo trajnime lidhur me këto raste, duke respektuar udhëzimet e Kryeprokurorit të Shtetit. Koordinatori po ashtu do të ofrojë bashkëpunim dhe koordinim me mekanizma ndërinstitucionalë dhe ndërkombëtarë, me qëllim të rritjes së efikasitetit në luftimin e narko-kriminalitetit dhe ndjekjes së kryerësve të këtyre veprave penale. Sipas nevojës, Koordinatori do t'i ofrojë bashkëpunim Koordinatorit Nacional kundër Narkotikëve.</p> <p>Korrupsioni - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 154 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 37 lëndë.</p>

	<p><u>Krimet ekonomike</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 171 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 11 lëndë.</p> <p><u>Trafikimi me njerëz</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 9 raste të pazgjidhura, ndërsa është zgjidhur 1 lëndë. Për këtë kategori të veprave penale, një (1) prokuror është caktuar koordinator. Koordinatori për rastet e trafikimit me qenieve njerëzore përcjell rastet e trafikimit me njerëz, mban evidencë për numrin e rasteve, mbështet prokurorët tjerë me këshilla sipas nevojës, njofton sipas kërkesës Zyren e Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me këto raste, si dhe merr pjesë në takime, seminare apo trajnime lidhur me këto raste, duke respektuar udhëzimet e Kryeprokurorit të Shtetit.</p> <p><u>Kontrabandimi me migrant</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 30 raste të pazgjidhura. <u>Nxitja e urrejtjes</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 3 raste të pazgjidhura.</p> <p><u>Sa i përket regjistrimit të lëndëve me kryerës të njohur PPN, në PTH në Prishtinë, janë të dhënat si në vijim:</u></p> <p><u>Drogat</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej ka mbetur 2 raste të pazgjidhur.</p> <p><u>Korrupsioni</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 461 raste të pazgjidhura, ndërsa janë zgjidhur 59 lëndë.</p> <p><u>Krimet ekonomike</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej kanë mbetur 87 raste të pazgjidhura.</p> <p><u>Trafikimi me njerëz</u> - në fund të periudhës raportuese, gjithsej ka mbetur 0 rast i pazgjidhur.</p> <p><u>Kontrabandimi me migrant</u> - në fund të periudhës raportuese, është zgjidhur 0 rast.</p>
11	<p>Niveli i zbatimit të kërkesave nga Komionet e Përherëshme të Këshillit dhe nga vet KPK-ja?</p> <p>Komento:</p> <p>Të gjitha kërkesat e adresuara nga KPK-ja janë zbatuar përpikërisht dhe brenda afateve.</p>
12	<p>Performanca e prokurorëve në përdorimin e sistemit SMIL ?</p> <p>Komento:</p> <p>Pothuajse të gjithë prokurorët e PTH në Prishtinë janë trajnuar në përdorimin e sistemit SMIL nga trajnerët përkatës. Përdorimi i sistemit është në nivele të mjaftueshme. Si sfida kryesore mbetet përdorimi i sistemit SMIL gjatë kujdestarive, për shkak të vonësive në pranimin e shkresave nga policia dhe përcjelljen e tyre në gjykatë përmes sistemit. Veçanërisht, kjo pengesë shfaqet gjatë ditëve të kujdestarisë të cilat bien gjatë vikendit apo festave zyrtare, për shkak të mungesës së stafit administrativ për të regjistruar dhe procesuar shkresat përmes sistemit.</p> <p>Edhe pse prokurorët përgjithësisht kanë nivel të mjaftueshëm të njohurive rreth sistemit SMIL, një pjesë e tyre vazhdimisht ndihmohen nga stafi mbështetës, të cilët janë trajnuar plotësisht në përdorimin efektiv të këtij sistemi.</p> <p>Nga vlerësimi i përgjithshëm rreth përdorimit të sistemit SMIL, kemi verifikuar edhe nivelin e përdorimit të projektit SMIL nga vet prokurorët. Vlerësimi i prokurorëve është bërë duke i vlerësuar nga numri 1-10, andaj bazuar në këtë vlerësim edhe sot kemi këtë gjendje:</p> <p>- 20 prokurorë që përdorin sistemin SMIL në mënyrë të avancuar;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 6 prokurorë që janë përdorues të SMIL mbi mesataren,</li> <li>- 16 prokurorë janë përdorues të SMIL me nivel nën mesataren, si dhe të tjerët kanë nevojë ende për asistencë shtesë.</li> </ul> <p>Prokurorët që sot nuk e përdorin mjaftueshëm këtë sistem, kemi konstatuar se problemi kyç që mund të jetë pengesë është mosha, e që si pasojë e kësaj edhe aftësitë të tyre që të jenë përdorues të mirë të këtij sistemi është pak e vështirë, andaj edhe sot të njëjtit marrin ndihmë nga zyrtarët e sistemit SMIL-it.</p>
	<p>Sfidat apo të arriturat: Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese një ndër sfidat kryesore me të cilën përballën në vazhdimësi stafi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë është çështja e klimatizimit të objektit, e cila ndikon negativisht në procesin e punës, kjo për shkak se është e pamundur të punohet pa ndërprerje të herë pas herëshme të punës për shkak të temperaturave të larta në zyre, ku si pasojë e kësaj një numërit të madh të stafit administrativ dhe të prokurorëve i janë shkafqur probleme shëndetësore dhe pothuajse çdo javë është dashtë vij emergjenca.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese janë caktuar edhe dy koordinatorë</p> <p>Bekim Kodraliu – Kordinator për KHAIA (Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike)</p> <p>Sheribane Selimi – Kordinatore për veprat penale kundër integritetit seksual.</p> <p>Sa i përket të arriturve Kryeprokurori i Pth-së, në vazhdimësi zhvillon takime me Përfaqësues të Institucioneve vendore dhe Ndërkombëtare me qëllim të rritjes të bashkëpunimit dhe luftimit të krimit.</p>

#### IV. ZBATIMI I OBLIGIMEVE SIPAS PLANIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË SHITËTIT

1	<p>Objekti 1: Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale me prioritet.</p> <p>Komento: Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, mban takime të rregullta në baza mujore dhe ditore me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Hetuesisë, Inspektoratit Policor, si dhe akter ndërkombëtar me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe diskutimit për rritjen e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese, Kryeprokurori ka mbajtur takime edhe me hetuesit e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve Hekurudhore dhe Aeronautike, me qëllim të trajtimit sa më efikas edhe të këtyre rasteve, ku ndër të tjerash është vendosur që të caktohet një prokuror si pikë kontakti për këto raste e i cili do të dërgohet edhe në trajnime brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që të profilizohet për rastet në fjalë.</p> <p>Kryeprokurori çdo dy javë mban kolegji me prokurorët e dep. Përgjithshëm dhe me prokurorët e dep. Krime të Rënda dhe dep. për të Mitur, po ashtu vazhdimisht kërkon nga të gjithë që këtë vit të punojnë edhe më shumë, në mënyrë që të tregojmë efikasitet, të rrisim besimin e publikut, të bashkëpunojnë së bashku, e nëse duhet ndihmë të formohen grupe punuese në mënyrë që lëndët të trajtohen me kohë dhe në mënyrë sa më profesionale.</p> <p>Për nevoja të forcimit të departamentit të Krimeve të Rënda dhe Njësitit kemi kërkuar të shtohet numri i prokurorëve në këto departamente.</p>
---	---

Nga veprimet e lartcekura është shënuar një progres në trajtimin e lëndëve aktive brenda prokurorisë.

2 Objektivi 2: Fuqizimi i besimit të publikut në punën e Prokurorit të Shtetit.

Komento:

Objektivi 2: Fuqizimi i besimit të publikut në punën e Prokurorit të Shtetit.

Komento:

Përgjatë kësaj periudhe, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka hartuar në baza ditore raportin 24 orësh në kohë të paraparë dhe i është dërguar Zyrës për Informim në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Raporti 24 orësh vazhdon të sjellë rezultat të shkëlqyeshëm në përmirësimin e komunikimit të brendshëm në Prokurorinë Themelore-Prishtinë, duke kontribuar në procesin e punës si element pozitiv, e po ashtu edhe në komunikimin e jashtëm, përmes publikimit të këtij raporti kemi arritur t'i servojme publikut informata lidhur me veprimtarinë 24 orëshe të PThP-së dhe jo vetëm për opinionin publik, mediat online kanë prodhuar shkrime (lajme) për aktakuzat e ngritura çdo 24 orësh, me theks aktakuzat e ngritura për rastet e dhunës në familje dhe ato të natyrës korruptive.

Gjatë periudhës Korrik-Shtator 2022, prokuroria jonë ka hartuar dhe lëshuar për media gjithsej 17 komunikata/njoftime/sqarime, përfshirë edhe aktivitetet (takimet) ku prej tyre ka qenë 1.

Po ashtu, vlen të ceket se gjatë këtij tremujori, Zyra për Informim e Prokurorisë Themelore Prishtinë (zëdhënësja) ka dhënë 22 prononcime për Televizionet vendore, lidhur me çështje të ndryshme penale, si dhe është organizuar Konferencë për Media, më 5 shtator 2022, në të cilën janë shpallur veprimet e ndërmarra për rastin e 11 vjeçares në Prishtinë.

Temat të cilat janë publikuar përmes këtyre komunikatave i gjeni si në vijim:

#### 1.) Reagim nga Prokuroria Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 3 korrik 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, për hir të informimit të saktë të opinionit publik, reagon lidhur me shkrimin e publikuar në portalin "Paparaci", me titull "*Skandaloze, prokurorja Dulina Hamiti e liroi Nuredin Lushtaku*", pasi këto pretendime nuk qëndrojnë dhe janë tërësisht të pavërteta, sepse për incidentin i cili ka ndodhur mbrëmë, në Skenderaj, ku të lënduar kanë mbetur dy persona, prokurorja e apostrofuuar në këtë artikull, nuk është konsultuar nga policia lidhur me këtë rast, pasi që kjo çështje nuk bie në kompetencë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, mirëpo e mbulon Prokuroria Themelore në Mitrovicë.

2.) Kërkohej paraburgim ndaj një personi zyrtar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe falsifikim të dokumentit zyrtar

Prishtinë, 6 korrik 2022- Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Departamenti i Krimeve të Rënda, konkretisht Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente, ndaj të pandehurit R.M., në drejtim të veprave penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 dhe "Falsifikimi i dokumentit zyrtar", nga neni 427 të KPRK-së.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri, në cilësinë e personit zyrtar, në Zyrën e Gjendjes Civile në Komunën e Prishtinës, ka keqpërdorë detyrën zyrtare, duke regjistruar persona në sistemin elektronik të gjendjes civile, ashtu që ka tejkaluar kompetencat e tij.

I pandehuri, me urdhër të prokurorit gjendet nën masën e ndalimit prej 48 orësh nga data 05.07.2022.



3.) Sqarim për opinionin publik

**Prishtinë, 25 korrik 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë, për hir të informimit të saktë, bën të ditur për opinionin publik se, lidhur me rastin e znj. Bamieh, e cila ka qenë e ftuar për intervistim pranë kësaj prokurorie, është duke vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi, pasi bazuar në shkresat zyrtare që ka në posedim prokurorja e çështjes, më 03.06.2017, znj. Bamieh i është hequr imuniteti nga Kombet e Bashkuara dhe e njëjta sipas legjislacionit vendor, është udhëzuar nga prokuroria të angazhojë një avokat vendor, i cili është i licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës.

4.) Kërkohet paraburgim për të pandehurin për sulm seksual ndaj një të miture

**Prishtinë, 28 korrik 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se, më 27 korrik 2022, Prokurori i Shtetit nga Departamenti për të Mitur, ka ndahuar personin me inicialet H.M., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Sulmi seksual", të paraparë sipas KPRK-së.

Po ashtu, sot nga Prokurori i Shtetit është paraqitur kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit në gjykatën kompetente, për veprën penale të lartcekur.

Ndaj këtij rasti, prokuroria në koordinim me të gjitha institucionet relevante është duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

5.) Ndalohen dy persona të dyshuar se mashtruan bashkatdhetarët me bileta fiktive për udhëtim me aeroplan nga shtetet e perëndimit në Kosovë

**Prishtinë, 4 gusht 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se pas zhvillimit të masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit, në koordinim me Policinë dhe ATK-në, si dhe pas aprovimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, nën udhëheqjen e Prokurorit të Shtetit, sot është realizuar një aksion në Prishtinë dhe Podujevë, me ç' rast janë arrestuar dhe dërguar në mbajtje të dyshuarit M.K. dhe A.B., bashkëpronar të Agjencionit Turistik "Prishtina Jet", për shkak të dyshimit se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "Mashtrimi", të paraparë sipas KPRK-së dhe nga kjo bastisje e realizuar janë gjetur e sekuestruar prova të cilat do të shërbejnë në procedurën penale.

Personat e lartcekur dyshohen se, përmes paraqitjes së fakteve të rreme, pra përmes Agjencisë Turistike "Prishtina Jet", u kanë shitur të dëmtuarve/bashkatdhetarëve bileta fiktive për udhëtim me aeroplan nga shtetet e perëndimit në Kosovë me një çmim shumë më të lirë se sa çmimi aktual, e të cilat fluturime nuk janë realizuar edhe përkundër pagesave që janë bërë nga të dëmtuarit, çka me këtë të dëmtuarve përpos dëmeve financiare u kanë shkaktuar edhe keqtrajtme psikike, duke u maltretuar me familjarët e tyre nëpër aeroporte të ndryshme për realizimin e fluturimeve të premtuara rrejtshëm nga të pandehurit.

Të njëjtit me urdhër të Prokurorit të Shtetit janë dërguar në mbajtje prej 48 orësh, derisa ndaj tyre do të ndërmerren veprimet e mëtejme procedurale ligjore, si dhe, veprime hetimore ndaj rastit në fjalë, deri në epilogun përfundimtar të kësaj çështje penale.

6.) Kërkohet paraburgim për bashkëpronarët e "Prishtina Jet"

**Prishtinë, 5 gusht 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se, prokurori i çështjes ka kërkuar caktimin e paraburgimit në gjykatën kompetente për të pandehurit M.K., dhe A.B., në drejtim të veprave penale "Mashtrimi" dhe "Shmangia nga tatimi", të parapara sipas KPRK-së.

Sipas kërkesës, të pandehurit e lartcekur në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje me qëllim që vetit t'i sjellin përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme i kanë vu në lajthim një numër të konsiderueshëm bashkatdhetarësh, tani të dëmtuar, ku përmes Agjencisë Turistike "Prishtina Jet", u kanë shitur të dëmtuarve bileta fiktive për udhëtim me aeroplan nga shtetet e perëndimit për në Kosovë, duke ju ofruar oferta për blerje të biletave fiktive me një çmim shumë më të lirë se sa çmimi real, të cilat fluturime kanë qenë fiktive dhe si të tilla nuk janë realizuar përkundër pagesave që janë bërë nga të dëmtuarit, çka me këtë përpos dëmeve të mëdha financiare, të dëmtuarve dhe familjarëve të tyre u

kanë shkaktuar edhe maltretime psiqike duke i braktisur dhe lënë nëpër aeroporte të ndryshme të perëndimit pa i realizuar fluturimet e premtuara rrejtshëm nga të pandehurit.

Me këtë, të pandehurit në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale "Mashtrimi", nga nenin 323 të KPRK-së.

Ndërsa, i pandehuri M.K., në cilësinë e personit përgjegjës të subjektit afarist të lartcekur, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror ka bërë shmangie nga pagesa e tatimeve të parapara me legjislacionin tatimor në Kosovë, në atë mënyrë që i njëjti nuk i ka deklaruar saktë të hyrat dhe arkëtimet e realizuara nga qarkullimi i biznesit të tij te organet kompetente, respektivisht te ATK-ja.

Me këtë, i pandehuri kishte për të kryer veprën penale "Shmangia nga tatimi", nga nenin 307 të KPRK-së.

- 7.) Aktakuzë kundër dy personave për lëshim të çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorim të kartelave të bankës apo të kreditit

**Prishtinë, 9 gusht 2022**– Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Prokurori i Shtetit, pas zhvillimit të hetimeve, mbledhjes dhe analizimit të provave, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve A.S. dhe E.B., në drejtim të veprës penale "Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit", nga neni 301 lidhur me neni 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës, i pandehuri A.S., në vazhdimësi, në cilësinë e personit përgjegjës të ndërrimit në subjektin afarist "NEPTUN", me qëllim që vetit t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, ka keqpërdorur pozitën dhe besimin e klientëve duke iu vjedhur dhe fotografuar të dhënat e kartelave të tyre bankare, të cilat i kishin përdorur për të bërë blerje në dyqanin e lartcekur, e i cili pastaj këto të dhëna i ka përdorur duke bërë blerje të monedhave – kriptovalutave, ku më pas i ka shitur dhe i ka shndërruar në para kesh/euro, çka të dëmtuarve iu ka shkaktuar dëm material në shumën prej **6,124.1€**

Me këtë i pandehuri në vazhdimësi e ka kryer veprën penale "Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit", nga neni 301, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 dhe me nenin 77 të KPRK-së.

Ndërsa, të pandehurit A.S. dhe E.B., në bashkëkryerje, me qëllim që vetit t'i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, kanë keqpërdorur kartelën e bankës së një të dëmtuar, në atë mënyrë që i pandehuri A.B., në cilësinë e personit përgjegjës të ndërrimit në lokalin e lartcekur ka keqpërdorur pozitën dhe besimin e klientëve, respektivisht të dëmtuarës, duke ia vjedhur dhe fotografuar të dhënat e kartelës bankare të cilën e kishte përdorur për të bërë blerje në dyqanin e lartcekur, e i cili pastaj këto të dhëna i ka përdorur duke bërë blerje të monedhave – kriptovalutave, përmes e-mail adresave dhe llogari të tjera, të cilat ia kishte siguruar i pandehuri E.B., në këmbim të një shume të hollash/përqindje, ku pastaj i pandehuri A.S., kriptovalutat e krijuara në këto llogari më pas i ka shitur dhe i ka shndërruar në para kesh/euro çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në shumën prej **1.236.07€**.

Me këtë të pandehurit në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale "Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit", nga neni 301, paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që të pandehurit e lartcekur të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cila iu vihen në barrë.

- 8.) Ndalohen dy persona për veprën penale rrëmbimi

Prishtinë, 18 gusht 2022 - Me urdhër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, janë ndaluar dy (2) persona lidhur me rastin e zhdukjes së personit me inicialet B.R.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se dy (2) personat janë ndaluar për veprën penale "Rrëmbimi" nga neni 191 të KPRK-së.

Po ashtu, me rastin e arrestimit të këtyre dy personave janë sekuestruar edhe disa prova materiale të cilat do të shërbejnë për procedurë të mëtutjeshme penale.

Gjithashtu, kjo prokurori njofton opinionin publik se në këtë çështje penale, është duke punuar me seriozitetin maksimal dhe me të gjitha kapacitetet që disponon, si dhe në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës.

#### 9.) NJOFTIM NGA PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË

Prishtinë, 1 shtator 2022 - Prokuroria Themelore në Prishtinë njofton opinionin publik lidhur me rastin e dhunimit të 11 vjeçares në Prishtinë, ashtu siç ju kemi mbajtur të informuar, si rezultat i zhvillimit të hetimeve nga Prokurori i Shtetit në koordinim të plotë me institucionet e tjera relevante, janë dërguar në mbajtje pesë (5) personat e dyshuar të përfshirë në këtë rast, prej tyre dy madhori dhe tre të tjerë të mitur, për shkak të veprës penale "Dhunimi", sipas KPRK-së dhe për të njëjtit, Prokurori i Shtetit ka kërkuar masën e paraburgimit në gjykatën kompetente, me ç' rast gjykata ka aprovuar kërkesën e prokurorisë.

Prokurori i Shtetit në koordinim të plotë me institucionet relevante kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ofrimin e të gjitha shërbimeve për të dëmtuarën, kurse hetimet për këtë rast janë duke vazhduar, deri në epilogun përfundimtar të kësaj çështjeje penale.

Po ashtu, për hir të informimit të saktë, ju njoftojmë se në qershor të këtij viti, e mitura fillimisht është raportuar në stacionin policor në Prishtinë si person i zhdukur, me ç' rast është njoftuar prokurori kujdestar nga Departamenti për të Mitur i kësaj prokurorie, i cili ka autorizuar policinë në ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore dhe e njëjta është gjetur e intervistuar në prezencë të punëtores sociale dhe mbrojtësit të viktimave, si dhe, më pas është dërguar në strehimore.

Në mënyrë urgjente, prokurori kujdestar ka ndërmarrë veprime konkrete hetimore, me qëllim të sqarimit të plotë të rastit në fjalë. I njëjti ka lëshuar urdhëresat për ekzaminime dhe vlerësime të ndryshme. Po ashtu, në prezencë të psikologes, Qendrës për Punë Sociale dhe mbrojtësit të viktimave e mitura është marrë në pyetje nga Prokurori i Shtetit dhe ndaj të njëjtit rast janë duke vazhduar hetimet.

Të dy çështjet penale ndodhen në procese hetimore të ndara dhe i takojnë Procedurës për të Mitur, andaj, kufizimi i dhënies së informatave do të bëhet me qëllim të ruajtjes së integritetit të hetimeve dhe do të shmangët çdo publicitet i tepruar dhe informata që shpien në identifikimin e të miturve, pasi shkelin rëndë të drejtat e fëmijëve për privatësi dhe janë në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjet dhe Konventat Ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Në fund, ju njoftojmë se të gjitha procedurat ku janë të përfshirë të miturit janë procedura konfidenciale dhe fshehtësia e informacionit lidhur me fëmijën viktimë apo dëshmitarë mbrohet me ligj, e po ashtu, secili informacion që priret të bëjë identifikimin e fëmijës si dëshmitar apo viktimë, nuk botohet pa lejen e shprehur qartë të gjykatës.

10.) Reagim nga Prokuroria Themelore në Prishtinë

**Prishtinë, 3 shtator 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë reagon lidhur me deklaratën e Ministres së Drejtësisë, e cila ka kërkuar shkarkime dhe dorëheqje të personave brenda këtij institucioni të cilët nuk vepruan në kohë dhe sipas përgjegjësisë në rastin e 11 vjeçares.

Prokuroria Themelore në Prishtinë siguron edhe njëherë opinionin publik se trajtimi i rastit të 11 vjeçares nga ana e Prokurorit të Shtetit është bërë konform të gjitha dispozitave ligjore të cilat janë ndërmarrë në kohë dhe në mënyrë profesionale, në koordinim me institucionet e tjera relevante, andaj, për ne janë të pabaza dhe të papranueshme deklaratatë tilla publike.

Në vazhdim të kërkesave të kësaj prokurorie drejtuar organeve ekzekutive ka qenë kërkesë esenciale angazhimi i një psikologu pranë kësaj prokurorie, në trajtimin e çështjeve penale, sidomos atyre për të mitur, e cila kërkesë nuk është aprovuar asnjëherë me arsyetimin se nuk ka mjete buxhetore për ta mbuluar të njëjtën kërkesë, derisa e theksojmë se Prokurori i Shtetit ka vazhduar të trajtojë raste të tilla penale dhe do të mbetet i përkushtuar për përmbushjen e obligimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me këtë rast dhe të gjitha rastet e tjera të cilat i ka në trajtim, gjithmonë duke e ruajtur ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë institucionale.

11.) Ndalohet një person për mashtrim me subvencione e ushtrim të ndikimit

**Prishtinë, 8 shtator 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore në koordinim të plotë me policinë, konkretisht Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, me urdhër të Prokurorit të Shtetit është ndaluar personi me inicialet Xh.U., për shkak të dyshimit se ka kryer veprat penale "Mashtrimi me subvencione" dhe "Ushtrimi i ndikimit", sipas KPRK-së.

I dyshuari, në cilësinë e fermerit (përfituesit të subvencioneve), ka paraqitur te dhëna të rreme dhe jo të sakta me rastin e aplikimit për subvencione në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), me qëllim të përfitimit të subvencioneve duke i shkaktuar dëm të madh buxhetit të Republikës së Kosovës.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit i dyshuari është dërguar në mbajtje në kohëzgjatje prej 48 orësh.

12.) Ndalohet një person për veprën penale të dhunimit

**Prishtinë, 14 shtator 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ka ndaluar një person (madhor) në kohëzgjatje prej 48 orësh, nën dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale "Dhunimi", sipas KPRK-së, lidhur me rastin e 11 vjeçares, në qershor të vitit 2022.

Po ashtu, ju njoftojmë se Prokurori i Shtetit brenda afatit ligjor do të ushtrojë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit, në gjykatën kompetente.

13.) Aktakuzë ndaj katër personave për rastin e mashtrimit të qindra qytetarëve përmes Agjencisë "BCD Travel"

**Prishtinë, 16 shtator 2022-** Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se Prokurori i Shtetit, pas zhvillimit të hetimeve, mbledhjes dhe analizimit të provave, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve Sh.C., V.C., A.A dhe B.S., në drejtim të veprave penale "Mashtrimi", "Legalizimi i përmbajtjes së rreme" dhe "Shmangia nga tatimi", të parapara sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku janë të dëmtuar mbi 400 persona, ndërsa vlera e shumës së përfituar kundërligjshëm është mbi 667.950,00€.

Sipas aktakuzës, të pandehurit Sh.C dhe V.C., nga data 12.09.2019 e deri në fund të muajit tetor 2020, në Prishtinë, pas marrëveshjes paraprake dhe në bashkëkryerje në Agjencinë BCD TRAVEL, me seli në Bregun e Diellit, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore kanë hapur zyrën në Bregun e Diellit në Prishtinë, duke i mashtruar të dëmtuarit me premtimin se do t'ju caktohen terminet për viza dhe do t'ju sigurojnë viza pune në shtetet perëndimore dhe skandinave, me ç' rast të dëmtuarve ju është shkaktuar dëm material mbi 50.000€, dhe me këtë në vazhdimësi të pandehurit dhe në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale "Mashtrimi", sipas KPRK-së.

Të pandehurit A.A dhe Sh.C., nga muaji nëntor 2020 deri në shtator 2021, kanë mashtruar me dashje dhe në bashkëkryerje, duke qenë në dijeni se aplikacionet për viza nuk po procedohen në ambasadat përkatëse dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe tjetrin, e pandehura A.A., ju ka kërkuar paratë të dëmtuarve kinse për sigurimin e vizave, ka plotësuar "kontratat" për të dëmtuarit, si dhe ka "arsyetuar" tek të dëmtuarit arsyet e pritjet e gjata për vizat e punës, e po ashtu, nga profili i të njëjtës në rrjetin social "facebook" dhe "instagram", i ka postuar ofertat për punë, si dhe listat me emra dhe mbiemra të aplikantëve/tani të dëmtuarve që ju është "konfirmuar" caktimi i termineve për vizë dhe që do "të nënshkruajnë" kontratat për punësime jashtë vendit, ndërsa "aplikacionet" e të dëmtuarve nuk janë dorëzuar asnjëherë në ambasadat përkatëse, me ç' rast iu është shkaktuar dëm material mbi 50.000€ dhe me këtë në vazhdimësi të pandehurit, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "Mashtrimi", sipas KPRK-së.

Po ashtu, i pandehuri Sh.C., me dashje ka fshehur dhe i është shmangur tërësisht pagesës së tatimit që kërkohet me ligj duke mos i deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës, ku vlera e shumës së shmangur tatimore arrin shumën prej pesëdhjetëmijë (50.000€) Euro, andaj me këtë ka kryer veprën penale "Shmangia nga tatimi", sipas KPRK-së.

Ndërsa, i pandehuri B.S., me dashje ka vënë në lajthim Agjencinë e Regjistrimit të bizneseve të Kosovës (ARBK), që të vërtetojë një çështje të pavërtetë, në emër kinse të autorizuesit (pronar imagjinar i biznesit), duke e dhënë nënshkrimin e tij pa pasur autorizim, i cili autorizim ka shërbyer si provë në ARBK për të regjistruar "BDC Travel" Sh.p.k., dhe me këtë i njëjti ka kryer veprën penale "Legalizimi i përmbytjes së rreme", sipas KPRK-së.

Prokurori i Shtetit me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar Gjykatës t'ju vazhdohet masa e paraburgimit të pandehurve, po ashtu ka propozuar të konfiskohet dobia pasurore e fituar nga vepra penale: Njësia kadastrale me sipërfaqe 90.12 m<sup>2</sup>, në Glllogovc, njësia kadastrale me sipërfaqe 700 m<sup>2</sup> dhe njësia kadastrale sipërfaqe 1400 m<sup>2</sup>, në Pejë, banesa me sipërfaqe 83.5 m<sup>2</sup>, në Fushë Kosovë dhe një (1) automjet.

Po ashtu, prokurori i rastit i ka propozuar Gjykatës të shqiptohet dënim plotësues të pandehurve Sh.C dhe V.C., për kompensimin e dëmit/përbushjen e vlerës së dëmit të shkaktuar të dëmtuarve, si dhe, të pandehurit e lartcekur të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cila iu vihen në barrë.

14.) Ndalohet një person i dyshuar për falsifikim të dokumenteve, mashtrim e prezantim i tremë si person zyrtar

Prishtinë, 26 shtator 2022– Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinionin publik se pas zhvillimit të hetimeve disa mujore, në koordinim me Policinë e Kosovës-Krimet Ekonomike dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), sot ka arrestuar dhe dërguar në mbajtje personin me inicialet Sh.M., për shkak të dyshimit se ka kryer veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Mashtrimi" dhe "Prezantimi i remë si person zyrtar", sipas KPRK-së.

Personi i lartcekur dyshohet se, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, duke paraqitur dokumente të rrejshme dhe duke përdorur nënshkrimin e personit zyrtar të AKP-së, kinse si person zyrtar i autorizuar nga kjo Agjenci, nga viti 2019 e deri në vitin 2022,

ka bërë shpëtimin e aseteve që ndodhen në Bosnje e Hercegovinë dhe në Malin e Zi, ku me këto veprime i dyshuari ka kryer veprat penale të lartcekura.

I dyshuari ndodhet nën masën e ndalimit prej 48 orësh, derisa ndaj të njëjtit prokurori i çështjes do t'i ndërmerrë veprimet e mëtejme ligjore.

Po ashtu, në këtë është çështje penale me urdhër të prokurorit është sekuestruar një (1) veturë, një (1) telefon, para në vlerë prej 900€ (nëntëqind) euro dhe prova të tjera të cilat do të shërbejnë në procedurë.

Prokuroria në koordinim të plotë me institucionet e tjera relevante janë duke i ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore, me qëllim të sqarimit në plotëni të kësaj çështjeje penale.

15.) Diskutohet zgjidhja e rasteve përmes procedurës së ndërmjetësimit me ndërmjetësuesit e regjionit të Prishtinës

**Prishtinë, 29 shtator 2022-** Janë pritur në takim nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, përfaqësues nga Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës dhe ndërmjetësues të regjionit të Prishtinës, me pjesëmarrje të Udhëheqëses së Departamentit të Përgjithshëm të kësaj prokurorie, prokurorëve e zyrtareve të ndërmjetësimit për ta diskutuar rolin e procedurës së ndërmjetësimit në çështjet penale, si dhe efikasitetin e zgjidhjes së rasteve në saxe të kësaj procedure.

Me këtë rast, Kryeprokurori Munishi ka prezantuar sfidat në menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si prokuroria më e madhe në vend, si dhe funksionimin e Zyrës së Ndërmjetësimit në kuadër të kësaj prokurorie, duke vënë në pah se në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë referuar gjithsej 312 lëndë për ndërmjetësim, të cilat kanë përfunduar të zgjidhura me 300, falë bashkëpunimit të ngushtë të ndërmjetësuesve me prokurorinë.

Temë kryesore e këtij takimi ishte Ndërmjetësimi, si procedurë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mes të palëve, ku roli kryesor i takon ndërmjetësuesit si person neutral për t'i ndihmuar palët në arritjen e një marrëveshjeje (zgjidhjeje) përmes një komunikimi të mirëfilltë, e cila procedurë ka treguar rezultate të mira duke ndikuar në efikasitetin e zgjidhjes së rasteve të kësaj prokurorie, duke synuar gjithnjë të aplikohet në rastet kur i plotësojnë kushtet që vepra penale të jetë e dënueshme me gjobë dhe burgim deri në tre vjet.

Ndër tjerash, pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë zhvillimit të kësaj procedure, dhanë rekomandime për qëllim të informimit në masë më të madhe të qytetarëve me procedurën e ndërmjetësimit dhe të mirat që i gëzojnë nga kjo procedurë, si dhe sugjerime të tjera.

Në fund të diskutimit pjesëmarrësit u pajtuan që të mbajnë takime të vazhdueshme me qëllim të përmbushjes sa më efektive të përgjegjësisë në trajtimin e rasteve përmes procedurës së ndërmjetësimit.

16.) Diskutohet zgjidhja e rasteve përmes procedurës së ndërmjetësimit me ndërmjetësuesit e regjionit të Prishtinës

**Prishtinë, 29 shtator 2022-** Janë pritur në takim nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, përfaqësues nga Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës dhe ndërmjetësues të regjionit të Prishtinës, me pjesëmarrje të Udhëheqëses së Departamentit të Përgjithshëm të kësaj prokurorie, prokurorëve e zyrtareve të ndërmjetësimit për ta diskutuar rolin e procedurës së ndërmjetësimit në çështjet penale, si dhe efikasitetin e zgjidhjes së rasteve në saxe të kësaj procedure.

Me këtë rast, Kryeprokurori Munishi ka prezantuar sfidat në menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si prokuroria më e madhe në vend, si dhe funksionimin e Zyrës së Ndërmjetësimit në kuadër të kësaj prokurorie, duke vënë në pah se në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë referuar gjithsej 312 lëndë për ndërmjetësim, të cilat kanë përfunduar të zgjidhura me 300, falë bashkëpunimit të ngushtë të ndërmjetësuesve me prokurorinë.

Temë kryesore e këtij takimi ishte Ndërmjetësimi, si procedurë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mes të palëve, ku roli kryesor i takon ndërmjetësuesit si person neutral për t'i ndihmuar palët në arritjen e një marrëveshjeje (zgjidhjeje) përmes një komunikimi të mirëfilltë, e cila procedurë ka treguar rezultate të mira duke ndikuar në efikasitetin e zgjidhjes së rasteve të kësaj prokurorie, duke synuar gjithnjë të aplikohet në rastet kur i plotësojnë kushtet që vepra penale të jetë e dënueshme me gjobë dhe burgim deri në tre vjet.

Ndër tjerash, pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë zhvillimit të kësaj procedure, dhanë rekomandime për qëllim të informimit në masë më të madhe të qytetarëve me procedurën e ndërmjetësimit dhe të mirat që i gëzojnë nga kjo procedurë, si dhe sugjerime të tjera.

Në fund të diskutimit pjesëmarrësit u pajtuan që të mbajnë takime të vazhdueshme me qëllim të përmbushjes sa më efikase të përgjegjësi në trajtimin e rasteve përmes procedurës së ndërmjetësimit.

#### 17.) KOMUNIKATË E PËRBASHKËT PËR MEDIA NGA PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË DHE POLICIA E KOSOVËS

**Prishtinë, 30 shtator 2022** - Prokuroria Themelore në Prishtinë, njofton opinion publik se në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës, konkretisht Njësinë e Hetimeve të Përgjithshme në Prishtinë dhe institucionet e tjera relevante, në vazhden e hetimeve, janë siguruar prova shitesë lidhur me rastin e "Rrëmbimit" të B.R., me ç' rast është planifikuar që veprimet hetimore të bëhen edhe në terren me qëllim të identifikimit të lokacionit për gjetjen e personit në fjalë.

Gjatë ditës së sotme, prokurori i rastit së bashku me njësitë policore përgjegjëse, Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), kanë dalë në një zonë kodrinore-malore të Novobërdës dhe gjatë verifikimit të terrenit është arritur të identifikohet një lokacion i dyshimtë me të cilën pas gjurmimit nga njësitë përgjegjëse janë gjetur mbetje mortore (të dekompozuar), të cilat dyshohen se kanë të bëjnë me rastin e "Rrëmbimit" dhe të njëjtat do t'i nënshtrohen ekzaminimeve të nevojshme për të konstatuar identitetin e këtyre mbetjeve mortore.

Prokurori i Shtetit në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante janë duke vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve hetimore, andaj lidhur me zhvillimet e tjera rreth këtij rasti do t'iu mbajmë të informuar.

**\*Vërehet përmirësim në komunikimin e brendshëm, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të mirëfilltë.**

**Po ashtu, vërehet interesim më i madh i gazetarëve për ta konfirmuar informatën nga institucioni ynë para publikimit të saj, si dhe interesim në realizimin e prononcimeve me kamerë.**

3	<p>Objekti 3: Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale.</p> <p>Komento:</p> <p>Në prokurori kemi krijuar një data-bazë e cila përmban në mënyrë të detajuar të gjitha rastet penale që kanë të përfshirë edhe procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit. Kemi caktuar dy koordinatorë nga dy Departamentet në DKR dhe DP të cilët kanë të angazhuar nga një bashkëpunëtorë profesional, të cilët bëjnë përditësimin e vazhdueshëm të këtyre rasteve që nga hapi i parë e deri në fazat përfundimtare.</p> <p>Lidhur me punën e prokurorisë kemi një komunikim direkt me zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit përkatësisht me koordinatorin kombëtar dhe të njëjtit i raportojmë në mënyrë periodike lidhur me procedurat e sekuestrimit/konfiskimit.</p> <p>Për këtë periudhë janë paraqitur në DKR 4 kërkesa për sekuestrim, ndërsa në DP kemi pranuar gjithsej kërkesa</p>
4	Objektivi 4: Zvogëlimi i numrit të lëndëve në Prokurorinë e Shtetit.

	<p>Komento:</p> <p>Prokuroria Themelore në Prishtinë, mbështetur në të dhënat e gjeneruara, për periudhën Prill-Qershor 2022, paraqet të dhënat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë të bartura nga muaji mars 2022 janë 47.661 lëndë;</li> <li>- Lëndë të pranuar gjatë periudhës Prill-Qershor 2022 janë 4.655 lëndë ;</li> <li>- Lëndë të zgjidhura në këtë periudhë janë 2.616 lëndë;</li> <li>- Lëndë të papërfunduara në fund të periudhës Qershor 2022 janë 49.697 lëndë;</li> </ul> <p>Kryeprokurori vazhdimisht ka kërkuar nga prokurorët që për lëndët e ndërlikuara të kërkojnë që lënda e tyre të punohet në grup punues, në mënyrë që të merret barra e përgjegjësisë nga një grup i prokurorëve dhe veprimet hetimore të përfundohen me kohë.</p> <p>Prokuroria Themelore në Prishtinë ka të krijuara njësite të specializuara brenda strukturës së saj, në të cilat janë të angazhuar prokurorë të profilizuar në trajtimin e rasteve me natyrë më specifike siç janë krimet ekonomike, korrupsioni si dhe rastet e dhunës në familje. Kjo formë e organizimit bën që rastet e tilla të përfundohen më shpejtë dhe iu jepet rëndësia maksimale.</p> <p>Po ashtu, Prokuroria Themelore në Prishtinë i ka dhënë prioritet aplikimit të procedurave alternative për ato raste penale kur plotësohen kushtet e përcaktuara me ligj, kjo ka rezultuar që edhe numri i lëndëve aktive të zvogëlohet.</p>
5	<p>Objektivi 5: Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi i vazhdimësisë së punës në pandemi.</p> <p>Komento:</p> <p>Në këtë periudhë kemi punuar me kapacitet të plotë, marrë parasysh që më nuk ka pasur plane të reduktiveve si pasojë e pandemisë</p>
6	<p>Objektivi 6: Administrimi efikas, llogaridhënia dhe rritja e profesionalizimit:</p> <p>Komento:</p> <p>Është thelluar bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ashtu që përmes takimeve të rregullta kemi përmirësuar dukshëm bashkëpunimin dhe kemi arritur në ngritjen e profesionalizimit dhe mënjanimin të pengesave.</p> <p>Më tutje përmes komunikatave vazhdimisht kemi njoftuar publikun për trajtimin e rasteve brenda Kompetencave të lejuara për dhënien e informatave në çdo fazë të procedurës penale konform dispozitave ligjore.</p> <p>Vazhdimisht është kërkuar nga prokurorët raporte javore , mujore, tremujore gjashtëmujore, duke përfshirë njoftime lidhur me trajtimin e lëndëve, duke kërkuar që në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë përpilimin e shkresave, vendimeve e ankesave të dërguara si në gjykatë ashtu edhe në Institucione të tjera.</p> <p>Për këtë periudhë përmes Udhëheqësve të departamenteve nga prokurorët kemi kërkuar raporte lidhur me prioritetet në lëndë në baza tre mujore, dhe atë :</p> <p><i>Rezultatet për tre (3) mujorin e tretë të vitit 2022 (Korrik, Gusht, Shtator);</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Caktimin e rasteve të cilat ata i vlerësojnë se janë me prioritet;</li> <li><input type="checkbox"/> Kronologjinë e rasteve me prioritet;</li> </ul>



	<p>Ø Rastet për të cilat prokurorët kanë marrë aktvendim për fillim të hetimeve ose për të cilat do të marrin aktvendim për fillim të hetimeve;</p> <p>Ø Objektivat për 3 mujin e ardhshëm;</p> <p>Gjithashtu sa i përket lëndëve të Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion kemi shkuar te çdo prokuror për te parë veprimin e fundit dhe datën e veprimit te fundit per secilën lëndë.</p>
7	<p>Objektivi 7: Aplikimi më efikas i proceduarave alternative në zgjidhjen e rasteve penale.</p> <p>Komente:</p> <p>Duke parë rëndësinë e aplikimit të procedurës alternative të negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, vazhdimisht jemi përkushtuar që në lëndët që plotësohen kushtet të aplikojmë përdorimin e kësaj procedure. Po ashtu, kemi filtruar përsëri me kujdes secilën kërkesë për negociim të marrëveshjes për pranim të fajësisë në mënyrë që të rritet kualiteti i këtyre rasteve.</p> <p>Për PTH në Prishtinë, ndërmjetësimi edhe më tej mbetet një alternativë shumë e rëndësishme e cila po mundëson zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve, jep rezultate më të shpejta, ka kosto më të ulët dhe fleksibilitet më të madh dhe ndikon drejtpërsëdrejti në ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve.</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, është arritur gjithsej një (2) marrëveshje për pranim të fajësisë:</p> <p>Ndërmjetësimi:</p> <p>Për periudhën Prill-Qershor 2022, në Zyrën e Ndërmjetësimit ne Prokurorin Themelore Prishtinë janë referuar 119 lëndë, ndërsa janë zgjidhur 115 lëndë, me 303 persona.</p>
8	<p>Objektivi 8: Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i Prokurorit të Shtetit;</p> <p>Komente:</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, Kryeprokurori dhe prokurorët kanë pasur bashkëpunim të ngushtë me Institucionet vendore dhe ndërkombëtare.</p> <p><u>Procedurat e zhvilluara me Ndihmë Juridike Ndërkombëtare</u></p> <p>Edhe në këtë periudhë kujdes të veçantë i është kushtuar rasteve me kërkesa ndërkombëtare, duke ndarë si përgjegjësi shtesë për zyrën e kryeprokurorit që çdo kërkesë e natyrës urgjente dhe të tjera t'u ndihmojë prokurorëve, të njëjtat t'i vë në pah që të trajtohen sa më shpejtë, duke ofruar ndihmë profesionale. Prokuroria Themelore Prishtinë ka të caktuar dy (2) koordinator për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë. Përmes këtij përkushtimi si prokurori kemi pranuar vlerësime pozitive edhe nga Institucionet e tjera.</p> <p>Në këtë periudhë kemi pranuar gjithsej <u>25 kërkesa</u> për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë nga te cilat 21 jane te kryera.</p>

V. KËRKESAT SPECIFIKE TË KPK-së, (për periudhën e konkrete të shenjzuar të raportimit)

1	
2	
3	
4	
5	
6	
7	
8	

VI. ASPEKTE ADMINISTRATIVE:

Raportimi	Periudha kohore për të cilën raportohet	Shenjzimi
I parë:	Nga 1 janar deri më 31 mars të çdo viti	<input type="checkbox"/>
I dytë:	Nga 1 prill deri më 30 qershor të çdo viti	<input type="checkbox"/>
I tretë:	Nga 1 korrik deri më 30 shtator të çdo viti	<input checked="" type="checkbox"/>
I katërt:	Nga 1 tetor deri më 31 dhjetor të çdo viti	<input type="checkbox"/>

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kërkuar nga Kryeprokurori e ka dorëzuar raportin në Këshill (para raportimit):

Me datë: 25.10.2022

Me datë: \_\_\_\_\_





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
 Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE PRIJETIM  
 OSNOVNO TUŽILAŠTVO

DEPARTAMENTI ZEMË E KRYEPROKURORIT  
 DEPARTMAN

Shenja e kërkesës  
 Oznaka zahteva

**FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL - DOSTAVNICA ZA LIČNO URUČENJE**

Të panevojshmeve bjeru vizë - Nepotrební deo precrtati

Marrësi: Znj. MARGARITA GJOCAJ  
 Primalac: KPK

Titulli i shkresës që dorëzohet :  
 Naziv spisa koji se dostavlja:

1. Pasi marrësi nuk u gjet në vendin ku duhej të dorëzohej shkresa, dorëzimi u bë duke iu dhënë shkresa anëtarëve madhor të familjes së marrësit, kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që gjendet i inkuadruar në punë në të njëjtin vend.
2. Pasi marrësi ose pjesëtar i familjes së tij e ka refuzuar marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë, në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

RAPORTI I TMB 2022

1. Pošto primalac nije nađen na mestu gde je trebao spis da se uručuje, spis je dostavljen punoletnim članovima porodice primaoca - staratelju zgrade, komšiji, licu koji se nalazi na istom radnom mestu
2. Pošto je primalac ili član njegove porodice odbio primanje spisa, spis mu je ostavljen u stanu, radnom mestu primaoca (postavljajući to na vrata stana ili lokala gde se primalac poslom nalazi).

Numri i shtojcave:  
 Broj priloga :

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)  
 Potvrđujem da sam uzeo gorenavedeni spis (rečima)

[Signature] 26/10/22  
 Nënshkrimi i marrësit - Potpis primaoca

Më \_\_\_\_\_ në ora \_\_\_\_\_  
 Dana \_\_\_\_\_ u časova \_\_\_\_\_

Shkaku i refuzimit \_\_\_\_\_  
 Razlog odbijanja \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i dorzësuesit - Potpis dostavljača

Nënshkrimi i dorzësuesit - Potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruaj, nënshkrimi dërguesi duhet shënuar shkaku për marrësi nuk e vuri nënshkrimin e vet.

U situçaju da je primalac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostavljač s napomenom zašto primalac nije stavio svoj potpis.